


Tregtia e jashtme e mallrave

Gusht 2019

Tiranë, më 17 Shtator 2019: Në Gusht 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 20 mld lekë, duke u ulur me 2,0 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 27,8 %, në krahasim me Korrik 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u rritur me 6,8 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me 13,7 %, në krahasim me Korrik 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 32 mld lekë, duke u rritur me 13,3 %, krahasuar me Gusht 2018 dhe duke u ulur me 1,6 %, në krahasim me Korrik 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në tetëmujorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 200 mld lekë, duke u ulur me 2,5 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 429 mld lekë, duke u rritur me 3,1 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 229 mld lekë, duke u rritur me 8,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 2,0 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -9,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,1 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +9,1 pikë përqindje. “Produkte kimike dhe plastike” me +2,1 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,2 pikë përqindje.

Për publikim 17/09/2019

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Gusht 2019



Eksportet, gjatë këtij tetëmujori janë ulur me -2,5 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -4,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,8 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,7 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 6,8 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +1,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Gusht 2019



Si tetëmujor, importet janë rritur me 3,1 %, krahasuar me tetëmujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,8 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,5 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me -0,1 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Gusht 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Gusht 2018 janë: Franca (472,8 %), Gjermania (14,1 %), dhe Holanda (143,2 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-6,0 %), Kosova (-3,4 %) dhe Spanja (-19,9 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (19,7 %), Gjermania (5,9 %), dhe Kina (7,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-1,7 %), Spanja (-19,1 %) dhe Greqi (-2,6 %).

Në muajin Gusht 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Gusht 2018 janë: Italia (3,6%), Kina (18,2 %) dhe Turqia (15,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Gjermania (-1,8 %), Greqia (-5,9 %), dhe Rusia (-9,4 %).

Gjatë këtij tetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (18,1 %), Greqia (8,4 %) dhe Turqia (7,2 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-5,5 %), Gjermania (-9,6 %) dhe Rusia (-17,5 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Gusht 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 59,0 %, të gjithë tregtisë. Në Gusht 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (24,9 %), Kina (7,8 %), Gjermania (7,0 %) dhe Turqia (6,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për tetëmujorin e parë 2019, me vendet e BE zënë 64,5 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Gusht 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,8 %), Greqia (7,3 %), Kina (7,0 %) dhe Gjermania (6,3 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksperte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2017	Janar -2017	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
	Shkurt-2017	20	14,2	44	5,1	-24	45,7
	Mars-2017	24	22,0	54	14,9	-30	43,8
	Pril-2017	24	13,7	50	-3,9	-26	48,1
	Ma-2017j	24	18,2	56	7,4	-31	43,6
	Qeshor-2017	23	-0,1	57	9,2	-34	39,7
	Korrik-2017	25	9,9	55	9,6	-30	45,1
	Gusht-2017	18	12,3	49	6,2	-31	37,4
	Janar - Gusht 2017	177	12,9	400	6,3	-223	44,2
2018	Janar-2018	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	Shkurt-2018	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	Mars-2018	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	Prill-2018	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	Maj-2018	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	Qeshor-2018	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	Korrik-2018	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	Gusht-2018	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	Janar -Gusht -2018	205	16,2	416	4,1	-211	49,4
2019	Janar-2019	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	Shkurt-2019	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	Mars-2019	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	Prill-2019	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	Maj-2019	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	Qeshor-2019	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	Korrik-2019	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	Gusht-2019	20	-2,0	52	6,8	-32	38,9
	Janar-Gusht-2019	200	-2,5	429	3,1	-229	46,7

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Gusht 2018	Gusht 2019	Jan.-Gsh. 2018	Jan.-Gsh. 2019	Gusht 2018	Gusht 2019	Jan.-Gsh. 2018	Jan.-Gsh. 2019
Vendet e BE-së	13.973	14.201	156.709	152.162	28.182	28.044	256.554	253.357
Austri	142	116	1.148	1.263	515	660	4.448	4.673
Mbretëri e Bashkuar	75	59	612	481	463	622	3.837	3.786
Gjermani	1.031	1.176	9.204	9.747	3.936	3.864	32.795	29.630
Greqi	772	716	8.689	8.463	4.050	3.811	34.290	37.179
Itali	7.466	7.020	98.546	96.908	10.401	10.780	116.116	109.719
Spanjë	1.884	1.509	15.720	12.714	999	864	8.961	7.667
Kroaci	75	34	579	719	582	645	4.298	4.668
Të tjera të BE-së	2.528	3.571	22.209	21.867	7.235	6.799	51.809	56.035
Kinë	355	485	3.897	4.169	4.340	5.132	33.728	39.818
Kosovë	2.852	2.755	16.857	20.178	808	702	5.593	5.141
Maqedonia e Veriut	832	620	5.726	5.537	856	640	6.088	5.606
Rusi	11	-	29	74	1.461	1.323	9.365	7.723
SHBA	366	584	3.187	2.761	637	911	5.803	6.995
Turqi	280	140	1.379	1.356	4.147	4.778	33.920	36.378
Ukrainë	17	3	158	115	181	528	1.808	2.267
Zvicër	467	45	2.732	559	618	1.021	6.198	10.161
Të tjera	1.295	1.211	14.616	13.236	7.019	8.466	56.927	61.529
Gjithsej	20.449	20.045	205.292	200.146	48.249	51.545	415.985	428.975

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Gusht 2018	Gusht 2019	Jan.- Gsh. 2018	Jan.- Gsh. 2019	Gusht 2018	Gusht 2019	Jan.- Gsh. 2018	Jan.- Gsh. 2019
Gjithsej	20.449	20.045	205.292	200.146	48.249	51.545	415.985	428.975
Ushqime. pije. duhan	1.763	2.017	19.782	22.733	10.067	10.503	71.451	73.123
Minerale. lëndë djegëse. en.el.	5.405	3.549	39.972	31.729	5.523	6.777	42.023	52.861
Produkte kimike dhe plastike	444	874	3.682	5.206	6.806	7.289	58.260	57.825
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	119	56	1.916	1.630	809	773	12.488	11.651
Prodhime druri dhe letre	545	651	5.613	6.234	2.264	2.317	16.440	16.966
Tekstile dhe këpucë	6.732	6.455	82.144	80.385	4.819	5.010	56.400	56.903
Materiale ndërtimi dhe metale	3.737	2.901	35.538	31.362	5.739	6.270	51.074	54.418
Makineri. pajisje dhe pj. këmb.	1.119	2.982	11.155	14.896	9.957	10.651	91.355	89.370
Të tjera	586	558	5.489	5.971	2.264	1.955	16.494	15.858

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	98.546	96.908	16.857	20.178	15.720	12.714	9.204	9.747
Ushqim. pije duhan	4.799	5.191	1.866	2.479	782	897	929	1.096
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	3.178	3.962	3.813	4.951	12.597	10.007	1.545	755
Produkte kimike dhe plastike	976	1.340	847	1.398	28	33	18	44
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.413	1.346	6	4	178	146	6	8
Prodhime druri dhe letre	3.889	4.182	290	587	5	3	99	117
Tekstile dhe këpucë	63.262	62.533	75	59	1.988	1.472	4.843	5.100
Materiale ndërtimi dhe metale	11.908	9.213	8.582	9.083	127	146	503	1.079
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	6.621	6.640	502	479	5	6	884	1.009
Të tjera	2.499	2.502	874	1.137	10	2	378	539

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kinë		Greqi		Turqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	116.116	109.719	33.728	39.818	34.290	37.179	33.920	36.378
Ushqim. pije duhan	11.839	12.914	443	546	10.411	10.606	3.852	3.672
Minerale. lëndë djegëse. Energji elektrike	9.139	6.485	6	5	5.215	8.463	537	1.054
Produkte kimike dhe plastike	12.148	12.274	3.233	3.799	5.129	5.143	5.552	5.218
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	9.536	9.267	508	519	45	20	205	174
Prodhime druri dhe letre	4.831	4.425	758	711	2.249	2.317	2.180	2.310
Tekstile dhe këpucë	27.986	26.908	6.499	7.537	2.399	2.403	10.246	11.327
Materiale ndërtimi dhe metale	13.765	12.744	4.577	6.625	5.675	5.386	4.625	6.820
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	22.857	21.132	14.483	16.366	1.908	1.850	5.062	4.400
Të tjera	4.015	3.568	3.221	3.709	1.260	990	1.662	1.404

Metodologjia

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues. pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë. Gjermani. Francë. Itali. Luksemburg. Holandë. Mbretëria e Bashkuar. Danimarkë. Irlandë. Greqi. Spanjë. Portugali. Austri. Finlandë. Suedi. Qipro. Çeki. Estoni. Hungari. Letoni. Lituani. Maltë. Poloni. Sllovaki. Slloveni. Bullgari. Rumani. Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri